



BERAT

ORTOFOTO E PËRFTUAR NGA IMAZHET SATELITORE

Publikime në Gjeoportalin Kombëtar

Zonat e Mbrojtura


ASIG në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK), ka publikuar në Gjeoportalin Kombëtar për temën "Zonat e mbrojtura", informacionin gjeohapësinor për shtresat:

1. Zonat e mbrojtura të trashëgimisë kulturore (Pikë);
2. Zonat e mbrojtura të trashëgimisë kulturore (Poligon).

Këto shtresa përmbajnë zonat e mbrojtura të trashëgimisë kulturore që përfshijnë qendrat historike dhe zonat e tyre të mbrojtura, zonat arkeologjike të ndara sipas kategorive "A" dhe "B", duke u bazuar në intensitetin e pranisë së gjurmëve arkeologjike dhe zonat e mbrojtura të monumenteve të veçanta.



Kufijtë e Njësive Administrative, Rendi 4, Bashkia Kamëz




ASIG në bashkëpunim me bashkinë Kamëz, ka publikuar në Gjeoportalin Kombëtar Rendi 4 të Kufijve të Njësive Administrative, Bashkia Kamëz të miratuara me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 13, datë 15.02.2021, "Mbi miratimin e hartës së përditësuar të kufijve administrativo-territoriale "Për Bashkinë Kamëz", në zbatim të nenit 93, pika 2, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Të dhënat janë konform standardit të miratuar me VKM-në nr. 1078, datë 23.12.2015, Për miratimin e dokumentit "Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri, Tema: Kufijtë e njësive administrative".

Përditësimi i shtresave të Rrjetit Shtetëror Pasiv GNSS dhe të Rrjetit Shtetëror Gravimetrik të Republikës së Shqipërisë në Gjeoportalin Kombëtar

Korniza Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH) ka për qëllim të realizojë, nëpërmjet rrjeteve të pikave të kontrollit dhe stacioneve permanente sipas komponentëve përbërës të tij, një sistem referues unik gjeodezik nëpërmjet të cilit përcaktohen pozicioni planimetrik, lartësitë, shkalla, graviteti dhe orientimi për çdo pikë të territorit të Republikës së Shqipërisë. Në kuadër të këtij qëllimi, ASIG ka kryer përditësimin në Gjeoportalin Kombëtar të shtresave:

1. Rrjeti Shtetëror Pasiv GNSS i cili përbëhet nga pika të vendosura në mënyrë të tillë që së bashku me pikat e Rrjetit Shtetëror GNSS Aktiv sigurojnë një shpërndarje pothuajse uniforme në territorin shqiptar. Rrjeti Shtetëror GNSS Pasiv përbëhet nga dy rende: 1. Rrjeti GNSS Pasiv i Rendit të Parë; 2. Rrjeti GNSS Pasiv i Rendit të Dytë.
2. Rrjeti Shtetëror Gravimetrik i Republikës së Shqipërisë është pjesë e KRGJSH-së dhe ka në përbërjen e tij : 1. Rrjetin Shtetëror Gravimetrik të Rendit Zero; 2. Rrjetin Shtetëror Gravimetrik të Rendit të Parë; 3. Rrjetin Gravimetrik të Rendit të Dytë; 4. Rrjetin Gravimetrik të Rendit të Tretë (GRID); Pikat gravimetrike absolute të rendit zero (Shkodër, Tiranë, Sarandë) dhe 42 pikat e rrjetit gravimetrik relativ të rendit të parë përbëjnë Datumin Gravimetrik Shqiptar.



PJESËMARRJE NË AKTIVITETE

Konferenca Hapëse e Projektit “Softmove”



ASIG, i përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm znj. Vilma Tomço dhe z. Dritan Prifti, Drejtor i Drejtorisë së Përpunimit të të Dhënave Remote Sensing, në datën 29 Maj, mori pjesë konferencën e mbajtur me rastin e nisjes së projektit me tematikë: “U-Space dhe UAS: Mundësitë dhe sfidat për zonën IPA”, të mbajtur në Bari të Italisë.

Projekti “SOFTMOVE” i cili bazohet në objektivat e programit Interreg IPA, synon të forcojë bashkëpunimin ndërkufitar, për një zhvillim të qëndrueshëm të territoreve të përfshira me synimin e para-anëtarësimit të Shqipërisë dhe Malit të Zi në Bashkimin Evropian.

Workshop “Pricing and Open Data”

Në kuadër të projektit “SPATIAL II”, në datë 23 - 24 Maj u organizua workshop-i me temë: “Pricing and open data”.

Në këtë workshop morën pjesë ekspertë të fushës së marketingut nga Autoriteti Holandez i Kadastrës, drejtues të projektit SPATIAL II, si dhe përfaqësues nga të gjitha drejtoritë teknike të ASIG.

Fokusi i këtij workshop-i ishte ofrimi i njohurive të reja nga ekspertët holandez me qëllim organizimin e një marketingu sa më të plotë dhe cilësor të produkteve të ASIG.



TRAJNIME PËR GJEONFORMACIONIN

Në kuadër të nismës së ndërmarrë nga ASIG me qëllim rritjen e kapaciteteve teknike të Institucioneve Publike dhe Njësive të Qeverisjes Vendore, ekspertë të ASIG realizuan gjatë këtij muaji, trajnime për gjeoinformacionin me tematikat e mëposhtme:

- Njohja me funksionalitetet e Gjeoportalit Kombëtar;
- Mbledhja e të dhënave sipas temave të gjeoinformacionit;
- Prezantimi i produkteve të përfuara nga projekti i Shërbimit Satelitor.

Institucionet publike pjesëmarrëse në trajnime ishin:

1. Hekurudha Shqiptare (HSH)
2. Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH);
3. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN);
4. Autoriteti Portual Durrës (APD);
5. Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH);
6. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM);
7. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM);
8. Agjencia Kombëtare e Pyjeve (AKP);
9. Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB);
10. Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës-Kanalizimeve (AKUK);
11. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT).



Njësitë e Qeverisjes Vendore pjesëmarrëse në trajnime ishin:

- Bashkia Fier;
- Bashkia Mallakastër;
- Bashkia Patos;
- Bashkia Roskovec;
- Bashkia Himarë;
- Bashkia Vlorë;
- Bashkia Selenicë;
- Bashkia Cërrik;
- Bashkia Belsh;
- Bashkia Tiranë (Seanca 2).



Leksion i Hapur me Studentët e Inxhinierisë së Ndërtimit

Ekspertë të ASIG nga Drejtoria e Përpunimit të të Dhënave Remote Sensing zhvilluan më datë 9 Maj, në ambientet e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës, leksionin e hapur me temë: "Monitorimi i territorit me teknologji të avancuar".

Në këtë leksion morën pjesë pedagogë dhe studentë të Departamentit të Gjeodezisë, të cilët u njohën dhe diskutuan mbi temat e mëposhtme:

- Parimet Bazë të Remote Sensing;
- Koncepte të përgjithshme mbi satelitët Albania1 dhe Albania2;
- Aplikimet e shërbimeve të të dhënave satelitore;
- Vështrim i përgjithshëm i ecurisë së projektit;
- Analizimi i Imazherisë Satelitore.



BOTA E GJEONFORMACIONIT

Copernicus nxit inovacionin e teknologjisë shëndetësore

Copernicus për kujdesin shëndetësor zbulon potencialin e të dhënave të Copernicus Earth Observation për të ofruar njohuri për sektorët e kujdesit shëndetësor dhe farmaceutik, duke eksploruar korrelacionin midis shitjeve të medikamenteve kundër alergjisë dhe përhapjen e polenit.

Copernicus, përmes Shërbimit të tij të Monitorimit të Atmosferës (CAMS), ofron informacion themelor për polenin në mbarë botën. Copernicus në kujdesin shëndetësor, i udhëhequr nga IQVIA (Quintiles and IMS Health, Inc.) me bazë në Republikën Çeke, do të shfrytëzojë këto të dhëna për të kuptuar më mirë këtë sistem dhe për të identifikuar faktorët mjedisorë që shkaktojnë ngjarje të caktuara shëndetësore.

EUSPA nis zhvillimin e Evolucionit të ardhshëm të Shërbimit të Saktësisë së Lartë Galileo (HAS)

Agjencia e Bashkimit Evropian për Programin Hapësinor (EUSPA), nisi dy prokurime të reja kyçe në lidhje me Shërbimin e Saktësisë së Lartë (HAS) të nisur në janar 2023.

Ky angazhim jo vetëm që rrit aftësitë teknologjike të Galileo-s, por gjithashtu nxit inovacionin dhe rritjen brenda industrisë hapësinore të Bashkimit Evropian në fushën e saktësisë së lartë.

Qëllimi i prokurimit të Fazës 2 të Gjenerimit të të Dhënave me Saktësi të Lartë përfshin projektimin, zhvillimin, instalimin, kualifikimin, mbështetjen për akreditimin, pranimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së gjenerimit të të dhënave të saktësisë së lartë (HADG) për Fazën 2 të Shërbimit të Saktësisë së Lartë Galileo (HAS).

AKTIVITETE NË VIJIM

FOSS4G Europe 2024

Konferenca FOSS4GE, një ngjarje vjetore e Fondacionit Gjeohapësinor me Burim të Hapur (OSGeo), do të zhvillohet në Tartu të Estonisë. Ky aktivitet bashkon profesionistë të fushës së softuerit të gjeoinformacionit duke u fokusuar tek gjeoinformatika, hartografia dhe standardet e hapura, për të nxitur data sharing dhe zgjidhje inovative të problematikave të këtyre fushave.

1 - 7 Korrik 2024

www.asig.gov.al

International Geoscience and Remote Sensing Symposium (IGARSS)

IGARSS 2024 Simpoziumi Ndërkombëtar i Gjeoshkencës dhe Remote Sensing", do të zhvillojë një aktivitet 6 ditor, në Athinë të Greqisë. Ky aktivitet do të kontribuojë në shkëmbimin e pikëpamjeve, përvojave dhe trajnimit e shkencëtarëve të rinj, duke hapur perspektiva të reja për zhvillimin e kërkimit dhe investimet në këtë sektor.

7 - 12 Korrik 2024

International Conference of Environmental Remote Sensing and GIS

Fakulteti i Gjeodezisë i Universitetit të Zagrebit organizon "ICERS-Konferencën Ndërkombëtare Enviromental Remote Sensing and GIS", në Zagreb të Kroacisë. Ky aktivitet bën bashkë ekspertë të fushës së gjeoinformacionit, duke ofruar perspektiva të reja për trajtimin e sfidave mjedisore me teknologjinë e fundit të Remote Sensing dhe GIS.

11- 12 Korrik 2024

www.geoportal.asig.gov.al